

# STATUTI I SHOQËRISË “AL-KES” SHPK

## Titulli I

Data e themelimit, Emërtimi, Objekti, Kohëzgjatja, Zyra Qëndrore, Forma e Shoqërisë, Vula e Shoqërisë.

### Neni 1 : Datat e themelimit, Emërtimi dhe Themeluesit

Shoqëria “AL-KES” SHPK krijohet në datën 13 Qershor 2023 nga ortaku i vetëm i shoqërisë si më poshtë:

**Zj. Fiqirete Rustemaj**, atësia, Sherif, amësia Ruk, shtetësia Shqiptare, lindur në Tropojë dhe banues në Kamëz, Lagje 5, Rr. “Demokracia”; Nd. 026; H.00; Ap 00; Kamëz; Bathore; lindur më 20.12.1973, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me NID: H36220055T

Në bazë të Akt Themelimit të datës 13 Qershor 2023 ;

**Zj. Fiqirete Rustemaj**, atësia, Sherif, amësia Ruk, shtetësia Shqiptare, lindur në Tropojë dhe banues në Kamëz, Lagje 5, Rr. “Demokracia”; Nd. 026; H.00; Ap 00; Kamëz; Bathore; lindur më 20.12.1973, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me NID: H36220055T

Ortaku i vetëm po krijojnë statutin dhe aktin e themelimit në mbështje të ligjit të shoqërive Tregtare sipas kushteve dhe neneve të poshtë renditur

Për Shoqërinë më përgjegjësi të kufizuar (Shpk) me emrin tregëtar “AL-KES” Shpk

### Neni 2. Personaliteti Juridik

2.1 Shoqëria është person juridik shqiptar

2.2 Shoqëria gëzon të drejta si person juridik shqiptar, që prej datës në të cilën kryhet regjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2.3 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjisacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara në dokumentet themeluese (Akt Themelimi dhe Statuti)

### Neni 3 : Forma e Shoqërisë

3.1 Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK), derisa me vendim të Asamblese së Përgjithëshme të vendoset ndërrimi i formës ligjore.

### Neni 4 : Objekti

4.1 Shoqëria “AL-KES” Shpk do të ketë si objekt të veprimtarisë :

Studime, projektme, trajnime, konsulencë për: Projekte urbanistike, projekte arkitektonike, projekte konstruktive, projekte instalator, projekte për vepra hidraulike, projekte rrugësh – hekurudha, projekte urash dhe vepra arti, projekte gjeodet, studim gjeologo-inxhinierik-hidrogeologjik, projekte të impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, projekte të sinjalizimit rrugor, studime të sizmologjisë inxhinierike studime e projektme të ndërtimit dhe mbylljes së vend-depozitimeve të

mbetjeve të ngurta (urbane), studime e projektme të ndërtimit të impianteve të trajtimit të ujërave të zeza. Sherbim ekspertize ne vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe auditim mjedisor. Sherbim ekspertize ne mbrojtjen kunder zjarrit dhe shpëtimin. Sherbime ekspertize dhe profesionale lidhur me burimet energjetike. Sherbim ekspertize ne vleresim te pasurive te paluajtshme. Auditimi i eficenses energjitime ne ndertesa dhe industri. Sherbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore baze (sherbime te ekspertizes dhe/ose profesionale lidhur me pyje dhe/ ose kullota). Vleresimi i objekteve industriale te cdo lloji. Hartimi i planeve te evakuimit. Mbikeqyrja (supervizimi) dhe kolaudimi i punimeve te zbatimit per te gjitha kategorite e punimeve. Furnizim vendosje e linjave elektrike të TN, TM, TU mbi tokësore (ajrore) dhe nëntokësore (kabllore) për energji elektrike dhe telekomunikacioni, nënstacionet elektrike TN/TM dhe të tensionit të mesëm TM/TU (kabina elektrike). Furnizim vendosje e makineri pajisje per centralet energjistik te cdo lloji, rrjete inxhinierike, objekte civile dhe industriale. Realizimin e impianteve të telekomunikacionit. Mirëmbajtje, remont profilaktik të mesëm e capital të transformatorëve elektrik të çdo lloji, makinave elektrike si dhe pajisjeve elektrike. Import-eksport të materialeve elektrike, telekomunikacionit, sistemeve të alarmit, sistemeve kundra zjarrit, mjeteve kryesore dhe ndihmëse të prodhimit, tregtimin e mallrave të gatshëm si dhe cdo malli tjetër që parashikon ligji. Testimi dhe certifikimi i pajisjeve te ndryshme. Ofrimi i cdo lloji konsulence dhe sherbimi inxhinierik per te gjitha fushat e percaktuara ne kete objekt dhe ato qe parashikon ligji. Prodhimi i energjise elektrike nga hidrocentralet dhe burimet e tjera te rinovueshme. Hartimi i Planit te biznesit (analizes ekonomike) per cdo lloj veprimtarie. Menaxhimi i kontratave te ndryshme.

#### **Neni 5: Kohëzgjatja**

5.1 Shoqëria "AL-KES" Shpk kryen veprimtarinë e saj tregtare për një periudhë kohore të pacaktuar derisa të vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme.

5.2 Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në Ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

#### **Neni 6 : Selia**

6.1 Selia kryesore e shoqërisë do të jetë në Kamëz në adresën : Rruga Bulevardi Blu "Kompleksi Briana, kati 2 , Zona Kadastrale 2066 , nr. Pasurie 63/52 ; Kamëz.

Me vendim të Administratorit, selia e Shoqërisë mund të ndryshojë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, mund të hapen degë dhe zyra përfaqësimi të saj brenda dhe jashtë Shqipërisë.

#### **Neni 7 : Vula e Shoqërisë**

7.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj duke shënuar në të emërtimin tregtar ose iniciale

## **Titulli II Kapitali**

#### **Neni 8 : Kapitali Themeltar**

8.1 Kapitali themeltar do të jetë 100,000.00 (njëqind mijë lekë) i zotëruar nga ortaku si më poshtë:

Emër Mbiemër	% që zotëron	Kuotat që zotëron
<b>Fiqirete Rustemaj</b>	<b>100</b>	<b>1 kuotë</b>

8.2 Kapital gjithsej për shumën 100,000.00 (njëqind mijë lekë) është i ndarë në 1 (nje) kuota të zotëruar nga ortaku i vetëm si më poshtë:

1. **100% nga ortaku Zj. Fiqirete Rustemaj që përbën shumën e kapitalit e shprehur në vlerë monetare 100,000.00 (njëqind mijë lekë)**

8.3 Kapitali themeltar do depozitohet në një Bankë në Shqipëri me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër ose në arkën e shoqërisë.

#### **Neni 9: Kuotat, të drejtat e lidhura me to**

9.1 Çdo kuotë jep të drejtën e një vote për të marrë vendime sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Të gjitha votat do të ushtrohen nga ortakët sipas zotërimeve

#### **Neni 10: Kuotat. Fitimi, transferimi i kuotave.**

10.1 Kuotat e Kapitalit të shoqërisë mund të fitohen nëpërmjet kontributit në kapitalin e shoqërisë, shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit apo cdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

### **Titulli III**

#### **Asambleja e Përgjithshme**

#### **Neni 11 :Asambleja e Përgjithshme.Thirrja e mbledhjes.Marja e vendimeve.E drejta e votës.**

11.1 Asambleja e Përgjithshme, si organ kryesor i shoqërisë sipas ligjit për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Përfaqësohet në këtë shoqëri nga ortakët.

11.2 Asambleja e Përgjithshme thirret me shkresë jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së mbledhjes, në adresën e përcaktuar në dispozitën "Njoftimet" më poshtë. Njoftimi duhet të përmbajë ditën, orën, vendin ku do të mbahet mbledhja si dhe rendin e ditës. Njoftimi bëhet nga Administratori i shoqërisë apo nga çdo ortak tjetër, i cili përfaqëson të paktën 5% (pesë përqind) të totalit të votave në Asamblesë e Përgjithshme.

11.3 Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret të paktën njëherë në vit për të vendosur për çështje të tilla si : miratimi i bilancit dhe pasqyrave financiare, miratimi i raportit të auditimit të shoqërisë.

11.4 Mbledhjet mbahen në selinë e shoqërisë, ose në një vend tjetër të njohur nga ortakët e shoqërisë.

11.5 Vendimet merren nga Asambleja e Përgjithshme

#### **Neni 12 Kompetencat e Asamblesë**

12.1 Asambleja e Përgjithshme është kompetente për marrjen e vendimeve për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtëme:

1. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
2. Ndryshimin e Statutit
3. Emërimin/shkarkimin e Administratorit, ekspertëve kontabël, likuidatorëve.



4. Mbikëqyerjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratori përfshirë përgatitjen e pasqyrave
5. Financiare vjetore dhe mbulimin e humbjeve.
6. Miratimin e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
7. Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve
8. Kryerjen e kontroll revizionit financiar të shoqërisë me ekspertë të caktuar prej saj
9. Të vendosë për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit.
10. Të vendosë për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
11. Çështje të tjera që janë të rëndësishme për aktivitetin tregtar të shoqërisë.

#### **Neni 13 : Përfaqësimi në Asamble**

13.1 Ortaku mund të përfaqësohet në mbledhje, në rastet kur e ka të pamundur të jetë pjesëmarrës personalisht në mbledhje, nga një person i tretë edhe nga një ortak tjetër i shoqërisë. Autorizimi duhet të ketë të përcaktuar qartë kompetencat e përfaqësuesit si dhe të drejtat e tij lidhur me vendimarrjen në mbledhje.

### **Titulli IV** Administratori

#### **Neni 14 : Administrimi i shoqërisë**

14.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i shoqërisë do të jetë **Zj. Fiqirete Rustemaj**, atësia, Sherif, amësia Ruk, shtetësia Shqiptare, lindur në Tropojë dhe banues në Kamëz, Lagje 5, Rr. "Demokracia"; Nd. 026; H.00; Ap 00; Kamëz; Bathore; lindur më 20.12.1973, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me NID: H36220055T

#### **NENI 15 : Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit, Përgjegjësitë**

15.1 Administratori ushtron kompetencat e mëposhtëme:

1. Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme
2. Vepron me të tretë në emër dhe për llogari të shoqërisë brenda kompetencave të parashikuara në statut apo/dhe në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"
3. Kryen emërimin dhe shkarkimin nga puna të punëmarrësve të shoqërisë.
4. Jep urdhëra dhe udhëzime punëmarrësve dhe vendos sanksione ndaj tyre, në përputhje me kontratat e punës dhe rregulloret e brendëshme të shoqërisë.
5. Drejton dhe organizon punën në mënyrë të tillë që të sigurojë suksesin e shoqërisë në veprimtarinë e saj ekonomiko-financiare.
6. Të raportojë para Asamblesë së Përgjithshme sa herë që Asambleja e kërkon si dhe në rastet kur është i nevojshëm raportimi në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e Shoqërisë tregtare
7. Të zbatojë vendimet e mara nga Asambleja e Përgjithshme.
8. T'i paraqesë në mënyrë të rregullt dhe në kohë të përshtatëshme Asamblesë së Përgjithshme, raportin e administrimit, inventarrit, bilancin dhe llogaritë vjetore si dhe të përgjigjet për to.



9. Të ushtrojë të drejta dhe detyrime të tjera të përcaktuara nga Ligji Nr 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”
10. Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të Ligjit dhe statutit dhe për falje të kryera gjatë administrimit sipas parashikimit të Ligjit nr 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

#### **Neni 16 Mbarimi i mandatit të Administratorit**

##### **16.1 Mandati i Administratorit përfundon :**

1. me mbarimin e afatit 5(pesë) vjeçar nga dita e emërimit, me të drejtë rizgjedhje.
2. me shkarkimin e tij nga Asambleja e Përgjithshme
3. kur vetë Administratori jep dorëheqjen vullnetarisht.
4. sipas mënyrave të tjera parashikuara nga Ligji Nr. 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

#### **Titulli V**

##### **Viti Financiar, Prishja e shoqërisë, Dispozitat e fundit**

#### **Neni 17 : Viti Financiar**

17.1 Veprimet financiare mbyllen në 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori merr masa lidhur me nxjerrjen e bilancit të hartuar konform ligjit mbi kontabilitetin dhe Pasqyrave financiare

#### **Neni 18: Mbarimi i Shoqërisë**

##### **18.1 Shoqëria “AL-KES ” Shpk mbaron:**

1. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme
2. Me hapjen e procedurave të falimentimit
3. Sipas shkaqeve të tjera të parashikuara nga Ligji Nr. 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

#### **Neni 19: Njoftimet**

19.1 Njoftimi për ortakun duhet të kryhet sipas adresës së përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti

19.2 ortakun është i detyruar të njoftojë ndryshimet në adresën e tij

#### **Neni 20: Të ndryshme**

20.1 Për çështjet që nuk parashikohen dhe rregullohen shprehimisht nga ky statut, gjejnë referim dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

20.2 Shoqëria “AL-KES ”SHPK, rregjistrohet sipas neneve 26, 28,32, e 35 të Ligjit Nr 9723.datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit

20.3 Statuti u hartua në 3(tre) kopje në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë juridike.

#### **THEMELUESI**

**Zj. Fiqirete Rustemaj**

